REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 44 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, nenit 17 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) nr.25/2020 për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr

VENDIM
PËR ZËVENDËSIMIN E KRYESUESIT TË GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E DRAFT - PLANIT PËR VLERËSIMIN E RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË TJERA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

I. Me këtë Vendim, **ZËVENDËSOHET**, kryesuesi i grupit punues për hartimin e Draft – Planit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit Sead Aliu, Drejtorati i Drejtoratit për Infrastrukturë në numrin rendor 1 i caktuar sipas Vendimit 1Nr.020-04-14693 të datës 30.03.2026 për formimin e grupit punues për hartimin e Draft – Planit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit, përshkak të ndryshimit të pozicionit të punës dhe në vend të tij caktohet:

BURIM RRUSTEMI, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime, Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim .

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Grupit punues janë të përcaktuara me dispozitat e Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr.020-04-14693 të datës 30.03.2026 për formimin e grupit punues për hartimin e Draft – Planit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:
Drejtoratit për për Shërbime, Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
Burim Rustemit, Drejtor i DSHMSH

1Nr.020-04-14693/ 2
Lipjan, 02.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 44 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, nxjerr

VENDIM
PËR ZËVENDËSIMIN E KRYESUESIT TË GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E DRAFT - PLANIT PËR REAGIM EMERGJENT NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

I. Me këtë Vendim, **ZËVENDËSOHET**, kryesuesi i grupit punues për hartimin e Draft – Planit për Reagim Emergjent në Territorin e Komunës së Lipjanit Sead Aliu, Drejtorati i Drejtoratit për Infrastrukturë në numrin rendor 1 i caktuar sipas Vendimit 1Nr.020-04-14698 të datës 30.03.2026 për formimin e grupit punues për hartimin e Draft – Planit reagim emergjent në territorin e Komunës së Lipjanit, përshkak të ndryshimit të pozicionit të punës dhe në vend të tij caktohet:

BURIM RRUSTEMI, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime, Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim .

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Grupit punues janë të përcaktuara me dispozitat e Vendimit të Kryetarit të Komunës 1Nr.020-04-14698 të datës 30.03.2026 për formimin e grupit punues për hartimin e Draft – Planit për reagim emergjent në territorin e Komunës së Lipjanit.

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:
Drejtoratit për për Shërbime, Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
Burim Rustemit, Drejtor i DSHMSH

1Nr.020-04-14698/ 2
Lipjan, 02.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 6 të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi Nr.15-345/02-33605 të datës 30.06.2023 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR SHPALLJEN E NJOFTIMIT PUBLIK PËR DHËNIEN E LICENCAVE PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME AUTOMJETE TAKSI

Neni 1

Të shpallet Njoftimi publik për dhënien e licencave për transportin e udhëtarëve me automjete taksi në qytetin e Lipjanit .

Neni 2

Njoftimi publik të shpallet në faqen elektronike të Komunës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim i Komunës së Lipjanit.

1Nr.020/04-50297
Lipjan, më 02.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit së Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Aktit - Plotësim Vendimit të Komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve për spërkatësve Nr.12-320/01-23118 i dates 21.05.2026, duke u bazuar edhe në Rekomandimin e Drejtorit të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari të datës 29.09.2026, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
PËR PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR NDARJEN E SPËRKATËSEVE PËR FERMERË TË KOMUNËS SË LIPJANIT 1Nr.320/01-49960 TË DATËS 30.09.2026

I.Me këtë Vendim, PLOTËSOHET neni 1 i Vendimit për ndarjen e spërkatëseve për fermerë të Komunës së Lipjanit 1Nr.320/01-49960 i datës 30.09.2026, ashtu që te pjesa tabelare, pas numrit rendor 16 shtohet numrii i ri, numri 17 me këtë përmbajtje:

17.	Avni	Milaim	Isufi	Gumnasellë

II.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtorati për Prokurim dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti do të publikohet në Webfaqen Zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Plotësimi i Vendimit për ndarjen e spërkatëseve për fermerë të Komunës së Lipjanit 1Nr.320/01-49960 i datës 30.09.2026 edhe me një përfitues te pjesa tabelare, bëhet duke u bazuar në Aktin përkatësisht Plotësim Vendimin e Komisionit për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve për spërkatëse me të cilin akt është plotësuar lista përfituese -plotësuese e spërkatëseve e shpallur me nr.13-320/01-20080 me datë 30.04.2026 për shkak të evidentimit të një gabimi teknik.

Nga të cekurat u vendos sin ë dispozitiv të këtij vendimi.

1Nr. 320/01-51009
Lipjan, më 07.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e listës përfundimtare për OJQ-të për Thirrje publike me Nr.05-453/01-43556 i datës|:25.08.2026 "Për ofrimin e mbështetjeve financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve lidhur me organizimin e aktiviteteve sportive "Sporti për Kategorinë e Seniorëve për vitin 2026" në Komunën e Lipjanit, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ -të

Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **9,000.00 €** (nëntëmijë euro), për t`i mbështetur financiarisht **OJQ**-të të cilat kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-43556 të datës 25.08.2026 "Për ofrimin e mbështetjeve financiare për financimin e projekteve të OJQ-ve lidhur me organizimin e aktiviteteve sportive "Sporti për Kategorinë e Seniorëve për vitin 2026".

2. Në tabelën vijuese janë OJQ-të të cila do të mbështetet finanaciarisht nga Komuna.

Nr.	Emërtimi i OJQ-ve	Shuma
1.	Klubi i PingPongut "Lipjani 2015"	**1,500.00 €**
2.	Klubi i Futbollit" Gadimja"	**7,500.00 €**
	Shuma Totale	**9,000.00 €**

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2026 të Drejtoratit për Kulturë ,Rini dhe Sport.

Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-ve do të rregullohen në kontratë e cila do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-ve përfituese.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë,Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr. 453/01-51924
Lipjan, më 14.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **6,720.00€,** (gjashtëmijë e shtatëqind e njezet euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-50193 e datës 01.10.2026, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 24 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin shtator të vitit 2026 me nga 280 euro për secilin rast 24 x 280 = 6,720.00€, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-50193
Lipjan, më 02.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 i datës, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

Neni 1
Përbërja

Formohet Komisioni për testimin e shpenzimeve të veturave zyrtare në këtë përbërje:

1. Behar Mjeku, Kryesues,
2. Rrahim Krasniqi, anëtar
3. Shefki Sadiku, anëtar,

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Detyrë e Komisionit është vërtetimi - testimi i saktë i shpenzimeve të të gjitha veturave zyrtare të Komunës.
Pas vërtetimit - testimit të saktë të shpenzimeve të të gjitha veturave zyrtare të Komunës, Komisioni duhet të përgadisë raport me shkrim të cilin duhet tia dorëzojë Kryetarit të Komunës dhe një kopje për Drejtoreshën e Drejtoratit për Administratë .

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtoresha e Drejtoratit për Administratë, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 020/04-52984
Lipjan, më 20.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021 dhe nenit 6 dhe 8 të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.345/02-33605 e datës 30.06.2023, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE TË OPERATORËVE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME AUTOMJETE TAKSI DHE VERIFIKIMIN E AUTOMJETEVE

Neni 1
Përbërja

Formohet, Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve për ushtrimin e veprimtarisë për transportin e udhëtarëve me automjete taksi dhe verifikimin e automjeteve, (në vazhdim të tekstit Komisioni) të cilët kanë aplikuar sipas Njoftimit publik 13Nr.-346-02-50558 të datës 05.10.2026, në përbërje si vijon:

1. Xhelil Murati, Kryesues
2. Salihe Marevci, anëtare
3. Liridon Zejnullahu, anëtar
4. Emine Deliu Mustafa, anëtare
5. Bujar Curri, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve sipas njoftimit të cekur publik, në afat prej 45 dite nga dita e pranimit të vendimit për formimin e komisionit, shqyrton aplikacionet, verifikon automjetet dhe harton Raportin me listën e operatorëve të cilët i plotësojnë kushtet për dhënien e Licencës, të cilin ia dërgon Drejtoratit për Shërbime Pulike Mbrojtje dhe Shpëtim
2. Punët ndihmëse administrative dhe teknike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-50297/2
Lipjan, më 15.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 60 paragrafi 3 dhe 85 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik , Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 21 e datës 16.09.2023 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT DISIPLINOR PËR STAFIN ARSIMOR

I. Me këtë Vendim, **themeloh**et Komisioni disiplinor për stafin arsimor , në këtë përbërje:

1. Mexhide Gashi, Kryesues i Komisionit
2. Besa Bislimi, anëtar i Komisionit
3. Raif Sadiku, anëtar i Komisionit

II. Komisioni disiplinor do ti shqyrtoj lëndët të cilat i adresohen sipas kompetencës për shkelejet e supozuara disiplinore të stafit arsimor në pajtim me procedurat disiplinore të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe dispozitave tjera ligjore që e rregullojnë këtë çështje.

III. Mandati Komisionit është dy (2) vjeqar.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me kopje të Vendimit njoftohen

Drejtori I DKA-së – Lipjan
Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit

1Nr. 020/04-52709
Lipjan, më 19.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 par. 4 dhe 5 i Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore ,nenit 72A të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar), neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, duke u bazuar në Kërkesën e Drejtorit të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari të datës 02.10.2026, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT AD.HOC PËR PRANIMIN E PASURISË JO FINANCIARE –FURNIZIMEVE, SHËRBIMEVE DHE PUNËVE

Neni 1
Përbërja e Komisionit

Për pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve,formoj Komisionin ad.hoc për projektin e Frezave,Spërkatëseve dhe për Traktor, sipas kontratës me numër 613-26-6476-1-2-1/C1243 ,në këtë përbërje:

1. Afrim Sadiku, Kryesues
2. Rrahim Krasniqi, anëtar
3. Shefki Sadiku, anëtar

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni në pajtim me dispozitat e Rregullores MF -Nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik (vendim i konsoliduar) bën pranimin e pasurisë jofinanciare përkatësisht furnizimeve, shërbimeve dhe punëve për projektin e Frezave,Spërkatëseve dhe për Traktor, sipas kontratës me numër 613-26-6476-1-2-1/C1243 dhe gjatë pranimit ka për detyrë si vijon :

1. Të verifikojë sasinë e porositur, cilësinë, llojin dhe vlerën e pasurisë jofinanciare në përputhshmëri me kontratën për urdhërblerjen.
2. Komisioni nuk duhet të pranojë pasurinë jofinanciare e cila nuk është në përputhje me kontratën dhe urdhërblerjen (mënyra e amabalazhimit, cilësisë llojllojshmërisë, plotësisë dhe marka e prodhimit).
3. Komisioni gjatë pranimit të pasurisë jofinanciare harton procesverbal dhe në rastet e mospranimit të pasurisë jofinaciare shënon edhe arsyetimin e mospranimit.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-51008
Lipjan, më 07.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 duke u bazuar edhe në Rekomandimin e Drejtorit të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari të datës 02.10.2026, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

I. Me këtë vendim, formohet Komisioni për monitorimin, kontrollimin dhe evidentimin e subvencioneve dhe mekanizmave bujqësorë të shpërndarë tek fermerët e Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Behar Aliu, Drejtorati për Administratë, Kryesues
2. Lulzim Qerimi, Zyra Lokale për Komunitete, anëtar
3. Shefqet Amerllahu, Drejtorati për Bujqësi dhe Pyltari, anëtar

II. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit, janë si vijon:

1. Të kontrollojë dhe të evidentojë të gjitha asetet - pajisjet apo mekanizimin bujqësor të dhënë në formë të subvencionit që u janë ndarë përfituesve, përmes projekteve të Komunës si dhe ato të siguruara në bashkëpunim me donatorë duke u bazuar në Marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet Komunës dhe përfituesve për tri vitet e fundit, përkatësisht rastet ku nga dita e pranimit të paisjes apo mekanizmit bujqësor nga fermeri/ia nuk kanë kaluar (3) tri vite.
2. Të evidentojë dhe kontrollojë asetet dhe pajisjet bujqësore të dhëna përfituesve, duke verifikuar nëse ato janë ende në posedim dhe në përdorim të përfituesit në përputhje me kushtet dhe periudhën e përcaktuar në Marrëveshjen për subvencionim.
3. Të realizojë vizita në terren te përfituesit dhe të verifikojë gjendjen faktike të pajisjeve, mekanizmave bujqësorë, serave dhe formave të tjera të mbështetjes.
4. Për secilin përfitues të plotësohet një formular standard i monitorimit, i cili do të përmbajë të dhënat e përfituesit, llojin e mbështetjes së pranuar, datën e përfitimit, gjendjen e pajisjes, mënyrën e përdorimit dhe të dhëna të tjera.
5. Gjatë vizitës në terren, Komisioni të bëjë dokumentimin fotografik të pajisjes apo asetit të përfituar, si dëshmi për gjendjen dhe përdorimin e tij.

6. Komisioni të përfshijë në formular edhe një pyetësor për vlerësimin e ndikimit të subvencionit me qëllim të evidentimit se sa i ka shërbyer pajisja apo mbështetja përfituesit, për çfarë qëllimi është përdorur dhe cilat rezultate konkrete janë arritur .

7. Të evidentohen rastet kur pajisjet apo asetet e përfituara nuk janë në posedim të përfituesit, janë tjetërsuar, shitur, dhënë personave të tjerë,.

8. Për secilin rast të evidentuar, Komisioni të përgatisë raport të veçantë me gjetjet dhe dëshmitë përkatëse, duke përfshirë fotografitë, formularin e kontrollit dhe dokumentacionin tjetër.

III. Lidhur me detyrat e lartëcekura, Komisioni ka për detyrë që të hartojë raport me shkrim për Kryetarin e Komunës më së largu me datë 28.04.2027 nga dita e dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

1 Nr.-020/04-50401
Lipjan, më 02.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 si dhe nenit 3 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Kompanisë Rajonale për Mbeturina "PASTRIMI" SH.A Nr.01-352/01-33705 të dates 21.07.2026 Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS

Neni 1
Caktimi i zyrtarit përgjegjës

Me këtë Vendim, **Liridon Zejnullahu**, Zyrtar i Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Lipjanit **CAKTOHET** zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Kompanisë Rajonale për Mbeturina "PASTRIMI" SH.A Nr.01-352/01-33705 të dates 21.07.2026.

Neni 2
Detyrat e Zyrtarit përgjegjës

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bashkëpunojë me Kompaninë Rajonale për Mbeturina "PASTRIMI" në cilësinë e mbikqyrësit të realizimit të punëve në terren, konform dispozitave të Marrëveshjes Bashkëpunimit të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Kompanisë Rajonale për Mbeturina "PASTRIMI" SH.A Nr.01-352/01-33705 të datës 21.07.2026

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Zyrtari Përgjegjës Liridon Zejnullahu dhe KRM "Pastrimi" Njësia në Lipjan.

1Nr. 112/02-52707
Lipjan, më 19.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti